

Raporti i Transparencës 2025

Teuta Nuni

Audituese Ligjore e Licencuar — Licensa Nr. 499, datë 09/06/2022

Anëtare IEKA | Tiranë, Shqipëri

contact@teutanuni.com | +355 69 20 51 333

Tiranë, Mars 2026

Mesazhi i Auditueses

Ky raport transparence paraqet praktikat dhe proceset profesionale, në përputhje me nenin 45 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009, i ndryshuar. Hartimi dhe publikimi i këtij raporti nuk është vetëm një detyrim ligjor, por është shprehja e bindjes se transparenca ndaj klientëve, palëve të interesuara dhe publikut të gjerë është themeli i besimit në profesionin e auditimit. Profesionin e auditimit shihet si një shërbim ndaj interesit publik, ku cilësia dhe besueshmëria janë parimet udhëheqëse.

Angazhimi kryesor është sigurimi i cilësisë dhe besueshmërisë në çdo angazhim profesional, duke ofruar shërbime me pavarësi të plotë, integritet dhe nivel të lartë ekspertize. Mjedisi profesional ndryshon me shpejtësi: standardet evoluojnë, pritshmëritë e klientëve rriten dhe kërkesat rregullatore shtohen. Për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve, ngrihen vazhdimisht standardet e brendshme të cilësisë, investohet në zhvillimin profesional dhe adoptohen praktikat më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

Ky raport ofron një pasqyrë të qartë mbi veprimtarinë dhe angazhimin e plotë ndaj cilësisë, transparencës dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore e profesionale.

Teuta Nuni

Struktura Ligjore dhe Pronësia

Veprimtaria e auditimit ushtrohet nga Teuta Nuni si person fizik i licencuar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), me licensë Nr. 499, lëshuar më 09/06/2022. Të gjitha vendimet profesionale merren drejtpërdrejt nga audituesja ligjore, e cili mban përgjegjësinë e plotë për çdo angazhim. Struktura operon në mënyrë të pavarur dhe nuk është pjesë e asnjë rrjeti kombëtar ose ndërkombëtar të auditimit.

Emri	Teuta Nuni
Forma juridike	Person Fizik (PF) — Auditues Ligjor
Licensa	Nr. 499, datë 09/06/2022
Organizata anëtare	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)
Rrjet ndërkombëtar	Asnjë — firma operon në mënyrë të pavarur
Adresa	Rr. "Reshit Collaku", P.Shallvare, H.7, Ap.97, Tiranë
Kontakt	contact@teutanuni.com +355 69 20 51 333

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Audituesja ligjore ka ndërtuar dhe zbaton një Sistem të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) të dokumentuar, në përputhje me ISQM 1 të IAASB. Sistemi zbatohet në mënyrë të shkallëzuar, proporcionalisht me natyrën dhe madhësinë e firmës individuale. Audituesja mban njëkohësisht rolin e partnerit të angazhimit dhe të personit përgjegjës për SMC-në, duke siguruar mbikëqyrje të plotë mbi cilësinë.

Ky sistem nuk është thjesht një procedurë administrative, por një kulturë cilësie e pranishme në çdo fazë të punës; nga pranimi i angazhimit deri në lëshimin e raportit final. Ai përfshin vlerësimin paraprak të pavarësisë dhe kompetencës, mbikëqyrjen aktive gjatë auditimit, si dhe rishikimin kritik të dokumentacionit dhe konkluzioneve përpara finalizimit të opinionit. Çdo rekomandim i dalë nga inspektimet e cilësisë trajtohet si pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm.

Konfirmohet se sistemi i menaxhimit të cilësisë ka funksionuar në mënyrë efektive gjatë gjithë vitit 2025.

Pavarësia dhe Etika Profesionale

Audituesja ligjore zbaton politika strikte për ruajtjen e pavarësisë dhe respektimin e kërkesave etike në çdo angazhim, në përputhje me Kodin e Etikës të IESBA dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Para çdo angazhimi nënshkruhet deklarata e pavarësisë me shkrim, e cila identifikon çdo marrëdhënie të mundshme me klientin dhe konfirmon mungesën e konfliktit të interesit. Po ashtu, çdo angazhim shoqërohet me deklaratën e konfidencialitetit, e cila garanton mbrojtjen e informacionit të klientit gjatë dhe pas përfundimit të angazhimit.

Politika e firmës parashikon gjithashtu monitorim të vazhdueshëm gjatë kryerjes së angazhimit për të identifikuar çdo kërcënim të ri ndaj pavarësisë që mund të lindë gjatë procesit. Kur identifikohen rreziqe, aplikohen masa mbrojtëse të dokumentuara në përputhje me kërkesat e Kodit IESBA. Integriteti dhe objektiviteti mbeten parime themelore që udhëheqin çdo vendim profesional.

Gjatë vitit 2025, në asnjë prej angazhimeve të kryera nuk u identifikua kërcënim ndaj pavarësisë ose kërkesave etike. Detyrimi i konfidencialitetit u respektua në mënyrë rigoroze, si ndaj klientëve të rinj ashtu edhe ndaj atyre të mëparshëm.

Zhvillimi Profesional i Vazhdueshëm

Audituesja ligjore zbaton me përpikmëri detyrimin e zhvillimit profesional të vazhdueshëm në përputhje me kërkesat e IEKA-s dhe standardet ndërkombëtare të vendosura nga IFAC. Investimi në zhvillimin profesional nuk trajtohet si një detyrim formal, por si një angazhim i vërtetë ndaj cilësisë dhe kompetencës profesionale.

Gjatë vitit 2025, audituesja ka vijuar programe trajnimi profesional duke përmblusur dhe tejkuluar kufirin minimal të kërkuar prej 40 orësh trajnim në vit. Trajnimet kanë mbuluar fusha thelbësore si Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe përditësimet e tyre, Standardin Ndërkombëtar të Menaxhimit të Cilësisë ISQM 1, Kodin e Etikës IESBA, legjislacionin fiskal dhe tatimor shqiptar, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, si dhe njohuri mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave.

Ky angazhim i vazhdueshëm ndaj trajnimit profesional siguron që çdo angazhim të kryhet me kompetencë të lartë, duke reflektuar përditësimet më të fundit të standardeve dhe praktikave ndërkombëtare.

Angazhimet e Vitit 2025

Gjatë vitit 2025, firma ka kryer angazhime të auditimit ligjor si dhe shërbime të tjera profesionale, në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Të

gjitha angazhimet janë zhvilluar duke respektuar parimet e pavarësisë, integritetit dhe profesionalizmit, duke siguruar cilësi dhe besueshmëri në raportim.

Ndër angazhimet e vitit 2025, firma ka kryer auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore të Anio Oil&Gas sh.a., si Njësi me Interes Publik (NIP).

Shërbimet profesionale të vitit 2025 kanë përfshirë gjithashtu auditime ligjore për subjekte të tjera jo-NIP, si dhe shërbime të konsulencës financiare dhe fiskale, të realizuara në mënyrë të dokumentuar dhe transparente. Është e rëndësishme të theksohet se shërbimet këshilluese janë kryer ekskluzivisht për klientë të ndryshëm nga ata të angazhimeve të auditimit, duke garantuar kështu pavarësinë e plotë të auditueses ligjore.

Aneksi A | Informacioni Financiar

Ndarja e të ardhurave vjetore të Teuta Nuni për vitin 2025, sipas kategorisë së shërbimit, paraqitet në tabelën më poshtë. Të ardhurat janë të shprehura në Lekë dhe përfaqësojnë vlera bruto para tatimeve.

Kategoria e shërbimit	Të ardhura (Lekë)	Pesha
Auditim ligjor — NIP (1 subjekt Anio Oil&Gas sh.a.)	720,000	10 %
Auditim ligjor — Jo NIP	797,000	12 %
Shërbime këshilluese financiare dhe fiskale	5,436,000	78 %
Totali	6,953,000	100 %

Tiranë, Mars 2026

Audituese Ligjore
Licensa Nr. 499

Teuta Nuni